



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

RREGULLORE (QRK) NR. 07/2023 PËR KOMPENSIMIN PËR KUJDESTARI, PUNËN GJATË NATËS DHE PUNËN JASHTË ORARIT TË PUNËS¹

REGULATION (GRK) NO. 07/2023 ON COMPENSATION FOR ON CALL, NIGHT WORK AND OVERTIME HOURS²

UREDBA (VRK) BR. 07/2023 O NAKNADI ZA DEŽURSTVO, NOĆNI RAD I PREKOVREMENI RAD³

¹ Rregullore (QRK) Nr. 07/2023 për kompensimin për kujdestari, punën gjatë natës dhe punën jashtë orarit të punës, është miratuar në Mbledhjen e 125-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 07/125, të datës 03.02.2023

² Regulation (GRK) No. 07/2023 on compensation for on call, night work and overtime hours has been approved in the 125th Meeting of the Government of the Republic of Kosovo, with the Decision no. 07/125, dated 03.02.2023

³ Uredba (VRK) Br. 07/ 2023 o naknadi za dežurstvo, noćni rad i prekovremeni rad, je usvojeno na 125, Sednici Vlade, sa Odlukom Br. 07/125, datum 03.02.2023

<p>Qeveria e Republikës së Kosovës,</p> <p>Në mbështetje të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 36, paragrafi 7 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe nenin 8, paragrafi 4, nën-paragrafi 4.5 i Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe nenin 19, paragrafi 6, nën-paragrafi 6.2 të Rregullores Nr.09/2011 së Punës së Qeverisë,</p> <p>Nxjerr:</p> <p>RREGULLORE (QRK) NR. 07/2023 PËR KOMPENSIMIN PËR KUJDESTARI, PUNËN GJATË NATËS DHE PUNËN JASHTË ORARIT TË PUNËS</p> <p style="text-align: center;">Neni 1 Qëllimi</p> <p>Kjo Rregullore ka për qëllim të përcaktojë kushtet, rregullat dhe procedurat për kompensimin për kujdestari, punën gjatë orarit të natës, punën jashtë orarit të rregullt të punës, gjatë ditëve të festave zyrtare dhe gjatë fundjavës.</p>	<p>Government of the Republic of Kosovo,</p> <p>In support of Article 93, paragraph 4, of the Constitution of the Republic of Kosovo, in accordance with Article 36, paragraph 7 of Law No. 08/L-196 on Salaries in the Public Sector and Article 8, paragraph 4, sub-paragraph 4.5 of Law No. 08/L-117 for the Government of the Republic of Kosovo, as well as Article 19, paragraph 6, sub-paragraph 6.2 of Regulation No. 09/2011 of Government Work,</p> <p>Issues:</p> <p>REGULATION (GRK) NO. 07/2023 ON COMPENSATION FOR ON CALL , NIGHT WORK AND OVERTIME HOURS</p> <p style="text-align: center;">Article 1 Purpose</p> <p>This Regulation aims to determine the conditions, rules and procedures for compensation of on call, night work, and overtime hours outside regular working hours, during official holidays and during the weekend.</p>	<p>Vlada Republike Kosovo,</p> <p>Na osnovu člana 93. stav 4. Ustava Republike Kosovo, u skladu sa članom 36. stav 7. Zakona br. 08/L-196 o platama u javnom sektoru i članom 8, stav 4, podstav 4.5 Zakona br. 08/L-117 o Vladi Republike Kosovo, kao i članon 19, stav 6, podstav 6.2 Poslovnika o radu Vlade br. 09/2011,</p> <p>Donosi:</p> <p>UREDBU (VRK) BR. 07/2023 O NAKNADI ZA DEŽURSTVO, NOĆNI RAD I PREKOVREMENI RAD</p> <p style="text-align: center;">Član 1 Cilj</p> <p>Svrha ove Uredbe je utvrđivanje uslova, pravila i procedura za naknadu za dežurstvo, noćni rad, prekovremeni rad, tokom službenih praznika i tokom vikenda.</p>
--	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 2 Fushëveprimi</p> <p>1. Kjo Rregullore zbatohet për të gjithë të punësuarit në sektorin publik, pagat e të cilëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, përjashtimisht Agjencisë Kosovare për Intelgjencë dhe funksionarëve publikë.</p> <p>2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, përderisa nuk cenohet pavarësia e tyre funksionale dhe organizative e garantuar me Kushtetutë, dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen edhe për Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe Institucionet e Pavarura Kushtetuese.</p>	<p style="text-align: center;">Article 2 Scope</p> <p>1. This Regulation applies to all employees in the public sector, whose salaries are financed by and through the state budget, with the exception of the Kosovo Intelligence Agency and public officials.</p> <p>2. With the exception of paragraph 1 of this article, as long as their functional and organizational independence guaranteed by the Constitution is not violated, the provisions of this Regulation also apply to the Presidency of the Republic of Kosovo, the Constitutional Court of the Republic of Kosovo, the Justice System, the Assembly of Republic of Kosovo and Independent Constitutional Institutions.</p>	<p style="text-align: center;">Član 2 Oblast delovanja</p> <p>1. Ova Uredba se sprovodi na sve zaposlene u javnom sektoru, čije se plate finansiraju iz i preko državnog budžeta, sa izuzetkom Kosovske obaveštajne agencije i javnih zvaničnika.</p> <p>2. Izuzev stava 1. ovog člana, sve dok se ne narušava njihova funkcionalna i organizaciona nezavisnost garantovana Ustavom, odredbe ove Uredbe sprovode se i za Predsedništvo Republike Kosovo, Ustavni sud Republike Kosovo, pravosudni sistem, Skupštinu Republike Kosovo i nezavisne ustavne institucije.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3 Përkufizimet</p> <p>Shprehjet, termat dhe shkurtesat e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptim të njëjtë, siç janë përdorur në ligjin përkatës për pagat në sektorin publik, ligjin përkatës për zyrtarët publik, si dhe legjislacionin relevant në fuqi.</p>	<p style="text-align: center;">Article 3 Definitions</p> <p>Expressions, terms and abbreviations used in this Regulation have the same meaning, as they are used in the relevant law on salaries in the public sector, the relevant law on public officials as well as the relevant legislation in force.</p>	<p style="text-align: center;">Član 3 Definicije</p> <p>Izrazi, termini i skraćenice koja se koriste u ovoj Uredbi imaju isto značenje, korišćenim u relevantnom zakonu o platama u javnom sektoru, relevantnom zakonu o javnim službenicima, kao i relevantnom zakonu na snazi.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 4 Llojet e kompensimeve</p>	<p style="text-align: center;">Article 4 Types of compensations</p>	<p style="text-align: center;">Član 4 Vrste naknada</p>
<p>1. Zyrtarët publik dhe kategoritë e tjera të të punësuarve që paguhen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, përfitojnë kompensim në vlerë monetare apo me pushim për punën në kujdestari, punën gjatë natës dhe jashtë orarit të punës, punën në fundjavë dhe punën në ditët e festave zyrtare.</p> <p>2. Kompensimi bëhet për rastet si në vijim:</p> <p>2.1. për kujdestari – në vlerë prej njëzet për qind (20%) në orë;</p> <p>2.2. punën gjatë natës – në vlerë prej tridhjetë për qind (30%) në orë;</p> <p>2.3. punën jashtë orarit të rregullt të punës – në vlerë prej tridhjetë për qind (30%) në orë;</p> <p>2.4. punën gjatë ditëve të festave zyrtare – në vlerë prej pesëdhjetë për qind (50%) në orë; dhe</p> <p>2.5. punën gjatë fundjavës – në vlerë prej pesëdhjetë për qind (50%) në orë.</p>	<p>1. Public officials and other categories of employees who are paid from the state budget, benefit from compensation in monetary value or with time off for on call work, working at night and overtime, working on weekends and working on official holidays.</p> <p>2. Compensation is made for the following cases:</p> <p>2.1. for on call hours – in the amount of 20% per hour;</p> <p>2.2. work during night shift - in the amount of 30% per hour;</p> <p>2.3. working overtime - in the amount of 30% per hour;</p> <p>2.4. work during official holidays - in the amount of 50% per hour; and</p> <p>2.5. work during the weekend - at the rate of 50% per hour.</p>	<p>1. Javni službenici i druge kategorije zaposlenih koji se plaćaju iz državnog budžeta ostvaruju naknadu u novčanoj vrednosti ili sa slobodnim danima za dežurstvo, noćni rad i prekovremeni rad, rad vikendom i rad na dan državnih praznicika.</p> <p>2. Naknada se vrši za sledeće slučajeve:</p> <p>2.1. za dežurstvo – u iznosu od 20% po satu;</p> <p>2.2. noćni rad - u iznosu od 30% po satu;</p> <p>2.3. prekovremeni rad - u iznosu od 30% po satu;</p> <p>2.4. rad tokom službenih praznika - u iznosu od 50% po satu; i</p> <p>2.5. rad tokom vikenda – u iznosu od 50% po satu.</p>

<p>3. Përveç nëse nuk përcaktohet ndryshe me legjislacionin në fuqi, vlera totale e kompensimit për punën shtesë nga orari i rregullt, nuk mund të jetë më e lartë se 1% e fondeve totale të përdorura nga organizata buxhetore në kategorinë e shpenzimeve “Paga dhe Shtesa” të atij viti fiskal.</p> <p>4. Përrjashtimisht nga paragrafi 3 i këtij neni, në situata emergjente, Qeveria me Vendim mund të tejkalojë këtë kufizim, ose titullari/organi udhëheqës në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe institucionet e pavarura kushtetuese, me vendim mund të tejkalojnë këtë kufizim. Ky përjashtim, duhet të jetë në harmoni me ligjin përkatës për menaxhimin e financave publike.</p> <p>5. Ministri përkatës i Financave përcakton formulën e llogaritjes së kompensimit sipas këtij neni përmes një vendimi të veçantë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 5 Kompensimi për kujdestari</p> <p>1. Institucioni që për shkak të specifikave</p>	<p>3. Unless otherwise stipulated by the legislation in force, the total value of the compensation for additional work from the regular schedule cannot be higher than 1% of the total funds used by the budget organization in the "Salaries and Allowances" expenditure category of that fiscal year.</p> <p>4. With the exception of paragraph 3 of this article, in emergency situations, the Government by Decision may exceed this limitation, or the heading /leading body in the Presidency of the Republic of Kosovo, the Constitutional Court of the Republic of Kosovo, the Justice System, the Assembly of the Republic of Kosovo and the independent constitutional institutions, by decision, can exceed this limitation. This exception must be in harmony with the relevant law on the management of public finances.</p> <p>5. The relevant Minister of Finance determines the formula for calculating the compensation according to this article through a separate decision.</p> <p style="text-align: center;">Article 5 Compensation for on call hours</p> <p>1. The institution that, due to the specifics and</p>	<p>3. Osim ako je drugačije određeno važećim zakonima, ukupna vrednost naknade za dodatni rad od redovnog radnog vremena ne može biti veća od 1% ukupnih sredstava koja budžetska organizacija koristi u kategoriji rashoda „Plate i dodaci“ te fiskalne godine.</p> <p>4. Izuzeto stava 3. ovog člana, u vanrednim situacijama, Vlada odlukom može prekoračiti ovo ograničenje, ili nosilac/vodeći organ u Predsedništvu Republike Kosovo, Ustavni sud Republike Kosovo, pravosudni sistem, Skupštini Republike Kosovo i nezavisne ustavne institucije, odlukom mogu prekoračiti ovo ograničenje. Ovaj izuzetak mora biti u skladu sa relevantnim zakonom o upravljanju javnim finansijama.</p> <p>5. Relevantni ministar finansija posebnom odlukom utvrđuje formulu za obračun naknade iz ovog člana.</p> <p style="text-align: center;">Član 5 Naknada za dežurstvo</p> <p>1. Institucija koja, zbog specifičnosti i</p>
--	--	--

<p>dhe nevojës së punës organizon punën me kujdestari, ka të drejtë të kompensojë të punësuarit për punën në kujdestari.</p> <p>2. Kompensimi për punën në kujdestari i takon të punësuarit në institucionin që ofron shërbime të vazhdueshme dhe të pandërprera, pra 24 orë në ditë, 7 ditë të javës.</p> <p>3. Për qëllime të kësaj Rregulloreje, kujdestari konsiderohet puna përtej orëve të rregullta të punës në institucionet sipas paragrafit 2.</p> <p>4. Puna në kujdestari përcaktohet përmes rregullativës së brendshme të institucionit dhe në përputhje me ligjin përkatës për punë.</p> <p>5. Kompensimi për punën në kujdestari është në vlerë prej njëzet për qind (20%) në orë.</p> <p>6. I punësuarit mund të kërkojë nga institucioni që në vend të kompensimit sipas paragrafit 5 të këtij neni, kompensimi t'i bëhet me ditë pushimi.</p> <p>7. Në raste të veçanta, në pajtim me ligjin përkatës për punë, institucioni mund të vendos që një pjesë e punës në kujdestari të kompensohet me ditë pushimi.</p>	<p>needs of the work organizes on call work , has the right to compensate employees for on call work.</p> <p>2. The compensation for on call work belongs to the employee in the institution that offers continuous and uninterrupted services, that is, 24 hours a day, 7 days a week.</p> <p>3. For the purposes of this Regulation, on call work is considered work beyond regular working hours in those institutions according to paragraph 2.</p> <p>4. On call work is defined through the institution's internal regulations and in accordance with the relevant labor law.</p> <p>5. The compensation for work in custody is in the amount of twenty percent (20%) per hour.</p> <p>6. The employee can request from the institution that instead of the compensation according to paragraph 5 of this article, the compensation is made with days off.</p> <p>7. In special cases, in accordance with the relevant labor law, the institution may decide that a part of the on call work is compensated with days off.</p>	<p>potreba rada, organizuje rad sa dežurstvom, ima pravo na naknadu zaposlenima za dežurni rad.</p> <p>2. Naknada za rad u dežurstvu pripada zaposlenom u instituciji koja pruža usluge kontinuirano i neprekidno, odnosno 24 časova dnevno, 7 dana u nedelji.</p> <p>3. Starateljstvom se, u smislu ove uredbe, smatra rad van redovnog radnog vremena u tim ustanovama prema stavu 2.</p> <p>4. Rad po pozivu je definisan internim aktima ustanove iu skladu sa relevantnim zakonom o radu.</p> <p>5. Naknada za rad u pritvoru je u iznosu od dvadeset posto (20%) po satu.</p> <p>6. Zaposleni može zahtevati od ustanove da se umesto naknade iz stava 5. ovog člana, naknada vrši sa slobodnim danima.</p> <p>7. U posebnim slučajevima, u skladu sa zakonom o radu, ustanova može odlučiti da se deo dežurstva nadoknađuje slobodnim danima.</p>
--	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 6 Kompensimi për punën gjatë natës (me ndërrime)</p>	<p style="text-align: center;">Article 6 Compensation for night work (with shifts)</p>	<p style="text-align: center;">Član 6 Naknada za noćni rad (sa smenama)</p>
<p>1. Institucioni që për shkak të specifikave dhe nevojës së punës i nevojitet orari i punës gjatë natës, gjegjësisht me ndërrime, duhet të paraqesë kërkesë në Ministrinë përgjegjëse për Administratë Publike për aprovim të punës me ndërrime.</p> <p>2. Kërkesa e paraqitur, sipas paragrafit 1 të këtij neni përmbanë:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. arsyeshmërinë e specifikave dhe nevojave për punën me ndërrime;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. propozimin e orarit të punës me ndërrime;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.3. pozitat për të cilat propozohet të punojnë me ndërrime jashtë orarit të zakonshëm të punës, duke përfshirë titujt, gradat dhe numrin e punonjësve për secilën pozitë; dhe</p> <p style="padding-left: 40px;">2.4. koston e vlerësimit financiar të kompensimit për punë me ndërrime.</p> <p>3. Ministria përgjegjëse për Administratë</p>	<p>1. The institution that, due to the specifics and needs of the work, needs working hours at night, i.e. with shifts, must submit a request to the responsible Ministry for Public Administration for approval of shift work.</p> <p>2. The request submitted, according to paragraph 1 of this article, contains:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. reasonableness of specifications and needs for shift work;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. proposal of working hours with shifts;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.3. positions for which it is proposed to work with shifts outside of normal working hours, including titles, ranks and the number of employees for each position; and</p> <p style="padding-left: 40px;">2.4. the annual cost of financial assessment of compensation for shift work.</p> <p>3. The Ministry responsible for Public</p>	<p>1. Institucija kojoj je, zbog specifičnosti i potreba rada, potrebno radno vreme noću, odnosno sa smenama, mora da podnese zahtev nadležnom ministarstvu za javnu upravu za odobrenje rada sa smenama .</p> <p>2. Podneseni zahtev, iz stava 1. ovog člana, sadrži:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1.obrazloženje specifikacija i potreba za rad u smenama;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2.predlog radnog vremena sa smenama;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.3. pozicije za koje se predlaže rad u smenama van redovnog radnog vremena, uključujući zvanja, stepen i broj zaposlenih za svaku poziciju; i</p> <p style="padding-left: 40px;">2.4 godišnji trošak finansijske procene naknade za rad u smenama.</p> <p>3. Nadležno ministarstvo za javnu upravu,</p>

<p>Publike, pas shqyrtimit të kërkesës, mund:</p> <p>3.1. të aprovojë orarin dhe pozitat për punë me ndërrime pëmes një akti administrativ të arsyetuar;</p> <p>3.2. të refuzojë kërkesën pëmes një akti administrativ të arsyetuar;</p> <p>3.3. të revokojë punën gjatë natës me ndërrime pëmes një akti administrativ të arsyetuar.</p> <p>4. Punë gjatë natës (me ndërrime) llogaritet puna e kryer në periudhën ndërmjet orës 22:00 deri në ora 06:00.</p> <p>5. Kompensimi për punën gjatë natës është në vlerë prej tridhjetë për qind (30%) në orë.</p> <p>6. I punësuar mund të kërkojë nga institucioni që në vend të kompensimit sipas paragrafit 5 të këtij neni, kompensimi t'i bëhet me ditë pushimi.</p> <p>7. Në raste të veçanta, në pajtim me ligjin përkatës për punë, institucioni mund të vendosë që një pjesë e punës gjatë natës (me ndërrime) të kompensohet me ditë pushimi.</p>	<p>Administration, after reviewing the request, may:</p> <p>3.1. to approve the schedule and positions for shift work through a reasoned administrative act;</p> <p>3.2. reject the request with justification.</p> <p>3.3. revoke night/shift work through a reasoned administrative act.</p> <p>4. Work at night (with shifts) is calculated as the work performed in the period between 22:00 PM and 6:00 AM.</p> <p>5. The compensation for night work is thirty percent (30%) per hour.</p> <p>6. The employee may request from the institution that instead of the compensation according to paragraph 5 of this article, the compensation will be made with days off.</p> <p>7. In special cases, in accordance with the relevant labor law and budget allocations, the institution may decide that part of the work at night (with shifts) be compensated with days off.</p>	<p>nakon razmatranja zahteva, može:</p> <p>3.1. da obrazloženim upravnim aktom odobrava raspored i mesta za smenski rad;</p> <p>3.2. odbije zahtev sa obrazloženjem.</p> <p>3.3. obrazloženim upravnim aktom ukida noćni/smjenski rad.</p> <p>4. Noćni rad (sa smenama) računa se kao rad obavljen u periodu od 22:00 do 06:00 časova.</p> <p>5. Naknada za noćni rad iznosi trideset posto (30%) po satu.</p> <p>6. Zaposleni može zahtevati od institucije da umesto naknade iz stava 5. ovog člana, naknada izvrši sa slobodnim danima.</p> <p>7. U posebnim slučajevima, u skladu sa relevantnim zakonom o radu i budžetskim izdvajanjima, institucija može odlučiti da se deo noćnog rada (sa smenama) nadoknadi slobodnim danima.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 7 Kompensimi për punën jashtë orarit, festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës</p>	<p style="text-align: center;">Article 7 Compensation for overtime work, official holidays and weekend days</p>	<p style="text-align: center;">Član 7 Naknada za prekovremeni rad, službene praznike i vikende</p>
<p>1. Zyrtarët publik dhe kategoritë e tjera të të punësuarve që paguhen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, kanë të drejtë të kompensohen për punën jashtë orarit të rregullt të punës, festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës.</p> <p>2. Puna jashtë orarit, festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës mund të realizohet vetëm kur i punësuarit ka pëlqim nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe ka autorizim paraprak të arsyetuar nga udhëheqësi më i lartë i institucionit.</p> <p>3. Kompensimi për punën jashtë orarit të rregullt të punës, punën gjatë festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës bëhet me pagesë ose me ditë pushimi.</p> <p>4. Kompensimi për punën jashtë orarit të rregullt të punës, punën gjatë festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës, llogaritet për çdo orë pune, duke i shtuar edhe vlerën si vijon:</p> <p style="padding-left: 40px;">4.1. Tridhjetë për qind (30%) në orë për punën jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve</p>	<p>1. Public officials and other categories of employees who are paid by and through the state budget have the right to be compensated for working overtime, official holidays and weekend days.</p> <p>2. Overtime work, official holidays and weekend days can only be done when the employee has the consent of the direct supervisor and has a prior, reasoned authorization from the highest leader of the institution.</p> <p>3. Compensation for overtime hours, work during official holidays and weekend days is made with payment or with a free working days.</p> <p>4. Compensation for overtime hours, work during official holidays and weekend days, is calculated for each working hour, adding the value as follows:</p> <p style="padding-left: 40px;">4.1. An additional thirty percent (30%) of the basic salary for full working overtime hour</p>	<p>1. Državni funkcioneri i druge kategorije zaposlenih koji su plaćeni iz državnog budžeta imaju pravo na naknadu za prekovremeni rad, službene praznike i dane vikenda.</p> <p>2. Prekovremeni rad, službeni praznici i dani vikenda mogu se obavljati samo ako zaposleni ima saglasnost neposrednog rukovodioca i prethodno obrazloženo ovlašćenje najvišeg rukovodioca ustanove.</p> <p>3. Naknada za rad van redovnog radnog vremena, rad za vreme službenih praznika i vikendom se plaća ili sa slobodnim danom.</p> <p>4. Naknada za rad van redovnog radnog vremena, rad tokom službenih praznika i vikenda, obračunava se za svaki radni sat, dodajući vrednost na sledeći način:</p> <p style="padding-left: 40px;">4.1. Trideset posto (30%) po satu za prekovremeni rad tokom radnih dana;</p>

<p>të punës;</p> <p>4.2. Pesëdhjetë për qind (50%) në orë për punën gjatë fundjavës;</p> <p>4.3. Pesëdhjetë për qind (50%) në orë për punën jashtë orarit gjatë festave zyrtare.</p> <p>5. I punësuar mund të kërkojë nga institucioni që në vend të kompensimit në vlerë monetare sipas paragrafit 4 të këtij neni, kompensimi t'i bëhet me ditë pushimi.</p> <p>6. Në pajtim me ligjin përkatës për punë, institucioni mund të vendosë që puna jashtë orarit të rregullt të kompensohet me ditë pushimi.</p> <p>7. Kompensimi për punë gjatë fundjavës, festave dhe ditëve të lira e përjashtojnë njëra-tjetrën.</p> <p style="text-align: center;">Neni 8 Procedura e miratimit të kompensimit për punën jashtë orarit, festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës</p>	<p>during working days;</p> <p>4.2. An additional fifty percent (50%) of the basic salary for full working hour during weekend work;</p> <p>4.3. An additional fifty percent (50%) of the basic salary for full working hour for overtime during public holidays.</p> <p>5. The employee may request from the institution that instead of the compensation in monetary value according to paragraph 4 of this article, the compensation be made with days off.</p> <p>6. In accordance with the relevant labor law and budgetary appropriations, the institution may decide that part of the work at night (with shifts) be compensated with days off.</p> <p>7. Compensation for work during weekends, holidays and days off are mutually exclusive.</p> <p style="text-align: center;">Article 8 Procedure for approving compensation for overtime work, official holidays and weekend days</p>	<p>4.2. Pedeset posto (50%) po satu za rad vikendom;</p> <p>4.3. Pedeset posto (50%) po satu za prekovremeni rad tokom državnih praznika.</p> <p>5. Zaposleni može zahtevati od ustanove da se umesto naknade u novčanoj vrednosti iz stava 4. ovog člana, naknada izvrši sa slobodnim danima.</p> <p>6. U skladu sa relevantnim zakonom o radu, ustanova može odlučiti da se rad van redovnog radnog vremena nadoknađuje slobodnim danom.</p> <p>7. Naknade za rad tokom vikenda, praznika i slobodnih dana se međusobno isključuju.</p> <p style="text-align: center;">Član 8 Postupak za odobravanje naknade za prekovremeni rad, službene praznike i dane vikenda</p>
--	---	---

<p>1. Kompensimi për punë jashtë orarit të rregullt të punës, gjatë festave zyrtare apo gjatë ditëve të fundjavës bëhet vetëm në rastet kur plotësohen kriteret e përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 7 të kësaj Rregulloreje.</p> <p>2. Kërkesa për kompensim për punë jashtë orarit të rregullt të punës, festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës aprovohet nga zyrtari më i lartë administrativ i institucionit më së largu dhjetë (10) ditë pas përfundimit të orëve shtesë, duke plotësuar Shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje.</p> <p>3. Kompensimi për punën jashtë orarit të rregullt të punës, festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës duhet të ekzekutohet më së largu gjashtëdhjetë (60) ditë nga dita e aprovimit të kërkesës.</p>	<p>1. Compensation for work outside regular working hours, during official holidays or during weekend days is made only in cases where the criteria defined in paragraph 2 of article 7 of this Regulation are met.</p> <p>2. The request for compensation for overtime work, during official holidays and weekend days must be approved by the highest administrative official of the institution no later than ten (10) days after the end of overtime hours, by supplementing Annex 1 of of this Regulation.</p> <p>3. Compensation for overtime work, official holidays and weekend days must be executed no later than sixty (60) days from the day of approval of the request.</p>	<p>1. Naknada za rad van redovnog radnog vremena, tokom službenih praznika ili tokom vikenda vrši se samo u slučajevima kada su ispunjeni kriterijumi iz stava 2. člana 7. ove Uredbe.</p> <p>2. Zahtev za naknadu za prekovremeni rad , za rad tokom službenih praznika i vikenda mora da odobri najviši administrativni službenik institucije najkasnije deset (10) dana po isteku prekovremenih sati, popunjavanjem Priloga 1 ove Uredbe.</p> <p>3. Naknada za prekovremeni rad, za rad tokom službenih praznika i dane vikenda mora se izvršiti najkasnije šezdeset (60) dana od dana usvajanja zahteva.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 9 Kushtet dhe planifikimi i buxhetit për pagesën e kompensimeve</p> <p>1. Institutionet publike çdo vit, së bashku me kërkesën vjetore për buxhet dorëzojnë në Ministrinë përgjegjëse për financa shumën buxhetore të nevojshme për kompensime për institucionin përkatës, sipas përcaktimeve të ligjit përkatës të pagave dhe kësaj Rregulloreje.</p>	<p style="text-align: center;">Article 9 Conditions and budget planning for the payment of compensations</p> <p>1. Public institutions every year, together with the annual budget request, will submit to the responsible Ministry for finance the budget amount necessary for compensation for the relevant institution, according to the provisions of the relevant salary law and this Regulation.</p>	<p style="text-align: center;">Član 9 Uslovi i planiranje budžeta za isplatu naknada</p> <p>1. Javne institucije svake godine, uz godišnji zahtev za budžet, dostavljaju nadležnom ministarstvu za finansije iznos budžeta neophodan za naknadu za relevantnu instituciju, u skladu sa utvrđivanjima relevantnog zakona o platama i ove Uredbe.</p>

<p>2. Çdo kompensim i përcaktuar me këtë Rregullore nuk mund të realizohet, nëse nuk është e planifikuar në buxhetin vjetor të institucionit përkatës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 10 Dispozitat kalimtare</p> <p>1. Për çështjet që nuk janë përcaktuar në këtë Rregullore, zbatohen dispozitat e Ligjit përkatës për Pagat si dhe dispozitat e Ligjit përkatës për Punë.</p> <p>2. Institucionet që kanë të miratuar dhe zbatojnë punën gjatë orarit të natës (me ndërrime) nuk kanë nevojë të kërkojnë aprovim, por vetëm njoftojnë ministrinë përkatëse për administratë publike. Njoftimi duhet të bëhet më së largu dhjetë (10) ditë nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje.</p> <p style="text-align: center;">Neni 11 Shtojcat</p> <p>Pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje është Shtojca 1 – Forma e Kërkesës.</p>	<p>2. Any compensation determined by this Regulation cannot be realized, if it is not planned in the annual budget of the relevant institution.</p> <p style="text-align: center;">Article 10 Transitional provisions</p> <p>1. For matters not defined in this Regulation, the provisions of the relevant Law on Salaries and the Provisions of the relevant Labor Law shall apply.</p> <p>2. Institutions that have approved and implement the on call work and during the night work (with shifts) do not need to seek approval, but only notify the relevant ministry for public administration. The notification must be made no later than ten (10) days from the entry into force of this Regulation.</p> <p style="text-align: center;">Article 11 Annexes</p> <p>Annex 1 – Request Form is an integral part of this Regulation.</p>	<p>2. Nijedna naknada utvrđena ovom Uredbom ne može se ostvariti, ako nije planirana godišnjim budžetom relevantne institucije.</p> <p style="text-align: center;">Član 10 Prelazne odredbe</p> <p>1. Za pitanja koja nisu definisana ovom Uredbom sprovede se odredbe relevantnog Zakona o platama i odredbe relevantnog Zakona o radu.</p> <p>2. Institucije koje su odobrile i sprovede dežurstva i noćni rad (sa smenama) ne moraju da traže saglasnost, već samo obaveštavaju nadležno ministarstvo za javnu upravu. Obaveštenje se mora izvršiti najkasnije deset (10) dana od stupanja na snagu ove Uredbe.</p> <p style="text-align: center;">Član 11 Prilozi</p> <p>Sasravni deo ove Uredbe je Prilog 1 – Obrazac zahteva.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 12 Shfuqizimi</p> <p>Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet çdo akt nën-ligjor dhe dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë Rregullore.</p> <p style="text-align: center;">Neni 13 Hyrja në fuqi</p> <p>Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.</p> <p style="text-align: right;">Albin KURTI</p> <hr style="width: 20%; margin: auto;"/> <p style="text-align: center;">Kryeministër i Republikës së Kosovës</p> <p style="text-align: right;">06 shkurt 2023</p>	<p style="text-align: center;">Article 12 Abrogation</p> <p>With the entry into force of this regulation, any sub-legal act and other provision that contradicts this regulation is repealed.</p> <p style="text-align: center;">Article 13 Entry into force</p> <p>This regulation enters into force on the day of publication in the Official Gazette of the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: right;">Albin KURTI</p> <hr style="width: 20%; margin: auto;"/> <p style="text-align: center;">Prime Minister of Republic of Kosovo</p> <p style="text-align: right;">06 February 2023</p>	<p style="text-align: center;">Član 12 Stupanje van snage</p> <p>Stupanjem na snagu ove Uredbe stavlja se van snage svaki podzakonski akt i druge odredbe koje su u suprotnosti sa ovom Uredbom.</p> <p style="text-align: center;">Član 13 Stupanje na snagu</p> <p>Ova Uredba stupa na snagu danom objavljivanja u Službenom listu Republike Kosovo.</p> <p style="text-align: right;">Albin KURTI</p> <hr style="width: 20%; margin: auto;"/> <p style="text-align: center;">Premijer Republike Kosovo</p> <p style="text-align: right;">06 februara 2023</p>
--	--	---



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Formulari për punën jashtë orarit të rregullt punës

Data: ____/____/____

Emri dhe mbiemri i punonjësit: _____

Numri i kartelës së punonjësit: _____

Emri i njësisë Organizative: _____

Orët e rregullta të punës: _____

Fillimi i orarit rregullt të punës: _____

Mbarimi i orarit të rregullt të punës: _____

	Orët e punuara jashtë orarit: Java: __/__/____ deri __/__/____			Arsyeja për punë jashtë orarit dhe të arriturat si rezultat i punës jashtë orarit
	Fillimi	Mbarimi	Orët totale	
E hënë (__/__/____)				
E martë (__/__/____)				
E mërkurë (__/__/____)				
E enjte (__/__/____)				
E premte (__/__/____)				
E shtunë (__/__/____)				
E diel (__/__/____)				

(nënshkrimi)

(nënshkrimi)

(emri dhe mbiemri i punëtorit)

(emri dhe mbiemri i udhëheqësit më të lartë të institucionit)

____/____/____

____/____/____

Shtojca 1 / Prilog 1 / Annex 1



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Obrazac za rad van redovnog radnog vremena

Datum: ____/____/____

Ime i prezime i zaposleni: _____

Broj kartice zaposlenog: _____

Naziv organizacione jedinice: _____

Redovno radno vreme: _____

Početak redovnog radnog vremena: _____

Kraj redovnog radnog vremena: _____

	Prekovremeni sati: Nedelja: ____/____/____ do ____/____/____			Razlog za prekovremeni rad i postignuća kao rezultat prekovremenog rada
	Počevši	Prekid	Ukupno sati	
Ponedeljak (____/____/____)				
Utorak (____/____/____)				
Sreda (____/____/____)				
četvrtak (____/____/____)				
Petak (____/____/____)				
Subota (____/____/____)				
Nedelja (____/____/____)				

(potpis)

(potpis)

(ime i prezime radnika)

____/____/____

(ime i prezime najvišeg rukovodioca ustanove)

____/____/____